



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.162/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagja Kalabri, rr. “Rexhep Krasniqi”, nr. 1, kundër debitorit “E.M. “ B.I, me numër unik identifikues 811310771 dhe seli në Xërxë, Komuna Rahovec, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.833/23 të datës 27.11.2023, me datën 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “E.M. “ B.I, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.833/23 të datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.833/23 të datës 27.11.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “E.M. “ B.I, me numër unik identifikues 811310771, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 28/23, i lejuar më datë 16.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Zija Bala. Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr. 28/23, i lejuar më datë 16.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Zija Bala.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.833/23 të datës 27.11.2023.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 16.03.2023 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartimor; Vendimit Nr. 03.1.1-2022-192, të datës 31.08.2022, me të cilin është caktuar përmbartimi dhe është urdhëruar debitori që në bazë të aktvendimit të ekzekutueshëm, të paguaj borxhin në lartësi prej EUR 90,009.81, me kamatë prej 0.65% mujore (7.80% vjetore), duke filluar nga data 13.09.2022, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbartimor, me arsyetim se i njejtë është i pabazuar, i paqartë dhe në kundërtënie me vete, ndërsa ka theksuar se nuk është vërtetuar saktë se dokumenti mbi të cilin është lejuar urdhri a është i ekzekutueshëm. Tutje, ka theksuar se debitori ndaj aktvendimit mbi të cilin është lejuar urdhri përmbartimor ka paraqitur padi për inicimin e konfliktit administrativ dhe rrjedhimisht vendimi është i pa ekzekutueshëm. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që ti përmbush të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditore në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara, ndërsa ka shtuar që vendimi i dhënë në procedurë administrative përbën dokument përmbartues në kuptim të nenit 22 të LPP-së. Tutje, ka shtuar se propozimi për përmbartim i përmban të gjitha elementet sipas nenit 38 të LPP-së, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.833/23 të datës 27.11.2023, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “E.M. “ B.I, me numër unik identifikues 811310771, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 28/23, i lejuar më datë 16.03.2023, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala. Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr. 28/23, i lejuar më datë 16.03.2023, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Vendimi Nr. 03.1.1-2022-192, i datës 31.08.2022, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 02.11.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi Nr. 03.1.1-2022-192, të datës 31.08.2022., është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është ne pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimit Nr. 03.1.1-2022-192, i datës 31.08.2022, i është dokument i përmbartueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 02.11.2022 ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbartjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organi përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbartim. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar padi për iniciimin e konfliktit administrativ mirëpo gjeti se bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbartimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbartimin.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.162/24, me datë 07.06.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**